

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6794
E premte, 30 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Studentët Patriotizëm
në liri është t'i bojkotojmë
produktet e Serbisë | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), MEMLI KRASNIQI, KA MBAJTUR
KONFERENCË PËR MEDIE PËR FUNDVIT | FAQE 4-5

KRASNIQI PËR QEVERINË KURTI: DËSHTUESE



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në konferencën përmblylëse për këtë fundvit, ka thënë se viti 2022 për Kosovën ka qenë vit i dështimit në energji, ekonomi,

arsim, diplomaci dhe shëndetësi. Duke e cilësuar qeverinë Kurti dështuese në të gjithë sektorët, Krasniqi ka thënë se një ndër fenomenet më tragjike të këtij viti ishte largimi

masiv i të rinjve nga Kosova. Ai ka theksuar se gjatë vitit 2022 PDK-ja është përpjekur të ndërtojë një pikëpamje të qëndrueshme për atë çfarë i duhet Kosovës

AKTUALE



SHOIPTAR DEMAÇI PËRKRAH
LULËKUQEN PËR SIMBOL TË
GJENOCIDIT NË KOSOVË | F. 6

MINISTRI MEHAJ I FTON
QYTETARËT TË KONTRIBUJNË NË
FONDIN E SIGURISË | F. 7

OPOZITA MAQEDONASE KËRKON
ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME | F. 2

EKONOMI



ATK-ja INKASOI 721 MILIONË EURO | F. 8

MINISTRJA HAJDARI DËNOHET PËR
MOSDEKLARIM TË PASURISË | F. 8

SPORT



JO VETËM RONALDON, AL NASSRI
SYNON TA TRANSFEROJË EDHE
RAMOSIN | F.13

LEWANDOWSKI: NË BARCELONË
NDIHEM SI NË SHTËPINË TIME | F.13



KRYESUESI
I KËSHILLIT
PROKURORIAL,
HAXHIUT: NUK
E PËRKRAHIM
NJË VETING
TË TILLË | FAQE 3



NIS HEQJA
E BARRIKADAVE
NË VERI | FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja do t'i shesë sistem kundërtank Tajvanit të kërcënuar nga Kina

WASHINGTON, 29 DHJETOR - Departamenti Amerikan i Shtetit ka miratuar një vendim që t'i shesë Tajvanit një sistem për hedhjen e raketave kundërtanke në mes të kërcënimit ushtarak në rritje nga Kina.

Departamenti tha të mërkurën se ky sistem dhe të gjitha pajisjet e lidhura me të do të kushtonin rreth 180 milionë dollarë. Ai është i aftë të shpërndajë mina kundërtanke dhe kundër personelit qoftë nga një automjet tokësor ose nga helikopteri. Njoftimi tregoi se Tajvani do ta blejë versionin nga automjetet. Shumë ekspertë besojnë se Tajvanit i duhet më shumë angazhim për të penguar ose zbrapsur një pushtim të mundshëm kinez.

Ditë më parë Kina dërgoi 71 avionë dhe shtatë anije në drejtim të Tajvanit në një shfaqje

24-orëshe të forcës drejtuar ishullit të vetëqeverisur që Kina pretendon se është territori i saj, tha të hënën Ministria e Mbrojtjes e Tajvanit.

Ngacmimi ushtarak i Kinës ndaj Tajvanit është shtuar vitet e fundit, së bashku me retorikën nga udhëheqësit kryesorë se ishulli nuk ka zgjidhje tjetër veçse ta pranojë sundimin eventuale kinez. Kjo ka bërë që krahu ushtarak gjithnjë e më i fuqishëm i Partisë Komuniste në pushtet, Ushtria Çlirimtare Popullore, të dërgojë aeroplanë ose anije drejt ishullit pothuajse çdo ditë.

Midis orës 6:00 të mëngjesit të së dielës dhe orës 6:00 të mëngjesit të së hënës, 47 avionë kinezë kaluan vijën mesatare të Ngushticës së Tajvanit, një kufi jozyrtar që dikur pranohej në heshtje nga të dyja palët, sipas Ministrisë së Mbrojtjes.



Kjo erdhi pasi Kina shprehu zemërimin ndaj dispozitave të lidhura me Tajvanin në një projekt-ligj vjetor të shpenzimeve të mbrojtjes të ShBA-së, në atë që është bërë një praktikë standarde

kineze. Kina, gjithashtu, kreu stërvitje ushtarake me zjarr të drejtpërdrejtë në gusht në përgjigje të vizitës së kryetares së Dhomës së Përfaqësuesve të

ShBA-së, Nancy Pelosi, në Tajvan. Pekini i sheh vizitat nga qeveritë e huaja në ishull si njohje de fakto e Tajvanit si të pavarur dhe një sfidë ndaj pretendimit të Kinës për sovranitet.

Opozita maqedonase kërkon zgjedhje të parakohshme

Shkup, 29 dhjetor - Kryetari i partisë opozitare, VMRO DPMNE, Hristijan Mickoski, ka thënë se Maqedonia e Veriut duhet të organizojë zgjedhje të parakohshme parlamentare që, sipas tij, "janë zgjidhja e vetme për dalje nga gjendja e rëndë, korrupsioni dhe paqëndrueshmëria politike".

Në konferencën e fundit para medieve për vitin 2022, ai tha se prioritet i partisë së tij është që zgjedhjet të mbahen në maj të vitit tjetër, me datat 14 ose 21. "Gjendja në vend është e padrueshme, por edhe brenda partive në pushtet, veçanërisht LSDM-së, BDI-së dhe Alternativës. Kërkohej një rivendosje e sistemit. Është



joreale ajo që thotë [Kryeministri] Dimitar Kovačevski, për zgjedhjet e vitit 2024, fillimisht zgjedhjet presidenciale dhe më pas ato parlamentare". "Në një rast të tillë zgjedhjet presidenciale do të jenë

të pasuksesshme dhe postin do ta mbajë kryetari i Kuvendit, ndërsa BDI-ja, përveç pozitës së kryetarit, do të ketë edhe kryeministër teknik sipas marrëveshjes që ka me LSDM-në, që do të thotë monopol nga

një parti politike", ka deklaruar Mickoski.

Ai ka thënë se opozita maqedonase nuk do t'i mbështesë ndryshimet kushtetuese për përfshirjen e pakicës bullgare në të ashtu siç parashikohet në marrëveshjen me Sofjen, ngaqë "nuk do t'u japin fund kërkesave bullgare për ta rrënuar identitetin maqedonas".

Reagimi i kreut të opozitës maqedonase vjen një ditë pasi ministri i Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, paralajmëroi se nga java e ardhshme do të shtohen konsultimet për sigurimin e shumicës prej dy të tretave në Kuvend, që janë të nevojshme për ndryshimin e

Kushtetutës maqedonase. Kërkesa për zgjedhje të parakohshme u mbështet edhe nga opozita shqiptare, e cila prioritet ka procesin e integritetit të Maqedonisë së Veriut në BE. Edhe Lëvizja Besa kërkon zgjedhje të parakohshme parlamentare, madje e kushtëzuar mbështetjen e saj për ndryshimet kushtetuese me shpalljen e zgjedhjeve të reja në vitin 2023.

Por, partitë në pushtet, Lidhja Social Demokratike (LSDM) dhe Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) thanë se zgjedhjet do të mbahen në afatin e rregullt në vitin 2024, ndërsa në vitin 2023 do të mbahen vetëm zgjedhjet e rregullta presidenciale.

Rusia godet me breshëri raketash Ukrainën

Kiev, 29 dhjetor - Rusia sulmoi Ukrainën me një breshëri raketash të enjten, disa prej të cilave kishin si objektiv Kievin dhe qytetin e Kharkivit. Ushtria e Ukrainës njoftoi se kishte rrëzuar 54 nga 69 raketat e lëshuara nga Moska. "Barbarizëm i pakuptimtë. Këto janë të vetmet fjalë që më vijnë në mendje teksa shohim Rusinë të lëshojë një tjetër breshëri raketash në qytetet paqësore të Ukrainës përpara vitit të ri", thuhej në një postim në medien sociale të ministrit të Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba. Ndihmësi i presidentit ukrainas, Mykhailo Podolyak, shkruante në

"Twitter" se Rusia kishte lëshuar të paktën 120 raketa me "synimin për ta shkatërruar infrastrukturën kritike e për të vrarë në masë civile".

Sirena që paralajmëronin sulmet ajrore ranë në të gjithë vendin. Kryetari i bashkisë së Kharkivit, Ihor Terekhov, njoftoi për shpërthime në qytetin e tij dhe tha se autoritetet po përcaktojnë se çfarë ishte goditur dhe nëse kishte viktima. Rusia ka përdorur në mënyrë të përsëritur raketa për t'i goditur qytetet ukrainase, duke përfshirë sulme që kanë shkatërruar objekte kritike të infrastrukturës.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Nis heqja e barrikadave në veri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Pasditen e së enjtes ka nisur largimi i barrikadave në fshatin Rudar i cili gjendet në komunën e Zveçanit. Barrikadat janë hequr nga rrugët edhe në komunën e Leposaviqit dhe të Zubin Potokut. Për qarkullim është liru edhe pika kufitare në Merdar. Sipas informatave nga terreni, po bëhen përgatitje për largimin e barrikadave edhe në Mitrovicë të Veriut.

Rrugët kryesore që çojnë drejt Jarinjës dhe Bërnjakut - pikat kufitare që lidhin Kosovën me Serbinë - ishin bllokuar që nga 10 dhjetori.

Barrikadat në veri të Kosovës u ngritën nga disa grupe serbësh për ta kundërshtuar arrestimin e një

ish-polici serb të Policisë së Kosovës.

Dejan Pantiq u arrestua nën dyshimet për sulm ndaj zyrtarëve kosovarë në fillim të dhjetorit.

Më 28 dhjetor Pantiqit iu zëvendësua masa e paraburgimit me arrest shtëpiak.

Për barrikadat Kosova ka fajësuar "bandat kriminale" që kanë mbështetjen e Serbisë.

Se barrikadat do të largoheshin tha të enjten presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas takimit me përfaqësuesit e serbëve nga Kosova.

Vuçiqi u takua me ta mbrëmjen e 28 dhjetorit në kazermën e Ushtrisë Serbe në Rashkë afër kufirit me Kosovën. Ai pati deklaruar të mërkurën se janë dhënë garanci se kërkesat e serbëve për heqjen e barrikadave do të plotësoheshin.

Kërkesat e serbëve janë: lirimi i ish-policit Dejan Pantiq, që "njerëzit që ishin në barrikada të mos ndiqen penalisht", dhe të mos lejohej hyrja e forcave speciale të Kosovës në veri.

Shefi për politikë të jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, ka thënë se "diplomacia mbizotëroi në uljen e tensioneve në veri të Kosovës". Ai përshëndeti kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin serb, Aleksandër Vuçiq. "Dhuna nuk mund të jetë kurrë një zgjidhje", shkroi Borrelli në një postim në "Twitter". "Tani kemi nevojë për përparim urgjent në dialog", shtoi Borrelli.

Ai, po ashtu, lavdëroi punën e BE-së, ShBA-së dhe KFOR-it lidhur me këtë çështje.

Kryeministri Albin Kurti ka

theksuar se barrikadat po hiqen nga ata që vetë i vendosen. "Vetë i vunë barrikadat, vetë i hoqën ato, me fjalë të tjera janë lodhur ata të cilët e bllokuan veten", ka thënë Kurti.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë thanë më 28 dhjetor se janë duke punuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për të gjetur një zgjidhje politike që të ulen tensionet në veri të Kosovës. Në një deklaratë të përbashkët, ShBA-ja dhe BE-ja mirëpritën garancitë e lidhshimit të Kosovës që konfirmuan se nuk ka lista për arrestimin e qytetarëve serbë ose përndjekjen e atyre që protestojnë paqësisht apo për vendosjen e barrikadave.

Gjatë natës disa kamionë, me të cilët ishte bllokuar rruga në

lokacionin e njohur si Shkëmbi i Dudës në Mitrovicë të Veriut, janë djegur. Sipas Policisë së Kosovës, përveç dëmeve materiale, nuk raportohet për persona të lënduar përderisa rasti është duke u hetuar. Këta kamionë ishin vendosur në këtë vend më 27 dhjetor, kur grupe të serbëve vendosën barrikada të reja në rrugët e veriut.

Vendosja e barrikadave nxiti tensione të shumta në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Serbia vendosi ushtrinë në gatishmëri si dhe rriti praninë ushtarake në vijën kufitare me Kosovën, përkatësisht në Rashkë të Serbisë.

Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkuar vazhdimisht largimin e barrikadave si dhe respektimin e marrëveshjeve të Brukselit.



Kryeprokurori i Shtetit kërkon nga kryeprokurorët angazhim në forcimin e sundimit të ligjit



Prishtinë, 29 dhjetor - Ushtruesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur takimin e fundit për vitin 2022, të Kolegjiut të kryeprokurorëve të prokurorive të vendit, në të cilin morën pjesë kryeprokurorët, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me të cilët ka diskutuar për çështje të ndryshme profesionale.

Fillimisht, kryeprokurorët raportuan lidhur me gjendjen në prokuroritë që ata i drejtojnë, përkatësisht për numrin e

lëndëve të pranuar, të zgjidhura dhe atyre në punë të të gjitha natyrave në departamentet përkatëse përgjatë vitit që po e lëmë pas.

Me këtë rast, u.d. kryeprokurori Kelmendi ka vlerësuar punën e prokurorive, duke i inkurajuar ta vazhdojnë angazhimin e tyre në trajtimin e të gjithave rasteve penale, me theks të veçantë atyre të krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të luftës, krimeve ekonomike, rasteve të dhunës në familje, rasteve kundër integritetit seksual etj.

Po në këtë takim kanë raportuar edhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të cilët janë të angazhuar si koordinatorë, duke i theksuar sfidat, vështirësitë dhe të arriturat në fushat që ata i mbulojnë.

Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, u ka uruar suksese dhe mbarësi në vitin e ri 2023 të gjithë kryeprokurorëve, prokurorëve të gjitha prokurorive dhe atyre të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, duke kërkuar nga ta të vazhdojnë të jenë të angazhuar për forcimin e sundimit të ligjit.

Abdixhiku e falënderon OSBE-në për mbështetjen e vazhdueshme dhënë Kosovës

Prishtinë, 29 dhjetor - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka prituri të enjten në takim

shefin e misionit të OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport. Gjatë këtij takimi është diskutuar për çështjet aktuale në vend,

situatën e krijuar në veri si dhe për procesin e dialogut. Abdixhiku ka falënderuar shefin e misionit të OSBE-së, Davenport, për

mbështetjen e vazhdueshme që OSBE-ja i ka dhënë Kosovës në proceset zhvillimore dhe demokratizuese.





KRYETARI I PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK), MEMLI KRASNIQI,
KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE PËR FUNDVIT

Krasniqi për qeverinë Kurti: Dështuese

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në konferencën përmblylëse për këtë fundvit, ka thënë se viti 2022 për Kosovën ka qenë vit i dështimit në energji, ekonomi, arsim, diplomaci dhe shëndetësi. Duke e cilësuar qeverinë Kurti dështuese në të gjithë sektorët, Krasniqi ka thënë se një ndër fenomenet më tragjike të këtij viti ishte largimi masiv i të rinjve nga Kosova. Ai ka theksuar se gjatë vitit 2022 PDK-ja është përpjekur të ndërtojë një pikëpamje të qëndrueshme për atë çfarë i duhet Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 29 dhjetor - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, në konferencën përmblylëse për medie, ka thënë se viti 2022 për Kosovën ka qenë vit i dështimit në energji, ekonomi, arsim, diplomaci dhe shëndetësi. Krasniqi ka thënë se viti që po e lëmë pas mund të përshkruhet me tri karakteristika: "Vit i stagnimit ekonomik përbrenda dhe inflacionit rekord; Vit i pasigurisë sociale për qytetarë dhe i ikjes së të rinjve; Një vit i dështuar politik për shtetin dhe

izolimim nga jashtë".

Ai ka thënë se kjo gjendje është rezultat i keqeverisjes së kryeministrit Kurti dhe kabinetit të tij qeverisës të cilët veçse i kanë thelluar krizat duke e tërhequr krejt Kosovën në një gjendje depresioni kolektiv e degradimi shtetëror. "Zhvillimet e fundit dëshmojnë më mirë se çdo gjë tjetër, që Kosova është duke kaluar një prej momenteve më të brishta që prej se është shpallur shtet sovran e, pa asnjë dyshim, një moment të brishtë dhe të paprecedentë pothuajse që 23 vjet pas çlirimit. Nuk është as e lehtë dhe as dëshirë e jona që vitin 2022 të mos mund ta

mbajmë mend për gjëra të mira por, fatkeqësisht, kjo është 'Kronikë e një dështimi të paralajmëruar' nga unë dhe PDK-ja qysh më 22 mars të vitit 2021, kur ishte emëruar Qeveria Kurti II. Kabineti i dobët dhe planprogrami i varfër i kësaj qeverie, por edhe përvoja me Qeverinë Kurti I, na kishin treguar qysh në fillim se çka na pret. Gjatë këtij viti kjo qeveri ka prodhuar gjithçka, përveç program zhvillimor e mbështetës për shtetin dhe qytetarët", ka theksuar ai. Krasniqi rikujtoi se ky vit pati nisur në një atmosferë të paralajmëruar të krizës energjetike nga opozita, zgjidhjen e së cilës qeveria e ka gjetur duke e shtrenjtuar energjinë elektrike në kurriz të qytetarëve. "Nga aranzhmanet e asaj periudhe, mbahen mend vetëm dy fakte kryeneqe. E para: Mbahet mend emri i ambasadorit Martin Berishaj dhe skandalit ndërkombëtar që lidhet me emrin e tij dhe mafisë energjetike, të cilin pushteti i Albin Kurtit jo që nuk e përballi me përgjegjësi, por e mbrojti me

këmbëngulësi. Dhe e dyta: Subvencionimi i energjisë për serbët në pjesën veriore të Kosovës në vlerë prej 100 milionë eurove", ka thënë ai. Kreu i PDK-së theksoi se ekonomia që u trumbetua se do të jetë e lirë dhe e drejtë gjatë vitit 2022 ka stagnuar dhe nuk është zhvilluar as si e drejtë, as si e lirë. "Sot, kur kostoja e jetesës në Kosovë është më e larta ndonjëherë, si pasojë e ngritjes së të gjitha çmimeve të produkteve esenciale, më së paku që kanë pasur nevojë qytetarët ka qenë keqeverisja dhe vendimet e panumërta në dëm të mirëqenies së tyre nga kjo qeveri. Madje, për më keq, në raportet ndërkombëtare për lirinë ekonomike, Kosova është degraduar për 28 vende më keq se në vitin 2021. Asnjë investim kapital për një vit të tërë, në kohën kur investimet kapitale janë instrument për ta zhbllokuar ekonominë nga kriza në të cilën jemi përfshirë, përderisa paratë e taksapaguesve, rreth 700 milionë euro që vegjetojnë në Bankën Qendrore, janë

zhvleftësuar nga inflacioni në vend se të përdoshin për ta lehtësuar ndikimin e krizës ekonomike", ka thënë Krasniqi. Ai ka potencuar se qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konsistent për t'ua lehtësuar familjeve kosovare përballjen me inflacionin, madje ka refuzuar edhe iniciativat e idetë sesi mund ta bëjë një gjë të tillë. "Tërheqja e mjeteve të TRUST-it nuk ishte kërkesë e PDK-së, mbi të gjitha ishte kërkesë e qytetarëve, të cilët, duke u ndier të braktisur nga qeveria, kërkonin së paku qasje në një pjesë të mjeteve të veta. Edhe kjo u është mohuar atyre. Për një vit, as edhe një investitor i huaj, as dhe një investim domethënës, ndërsa shkalla e papunësisë vazhdon të jetë enorme, përderisa numri i atyre që janë duke prekur vijën e varfërisë është rritur në përmasa të frikshme. Të gjitha këto i përmbledh më së miri rritja ekonomike si pasojë e kësaj qeverisje shterpe është vetëm rreth 2.5 për qind", ka thënë ai. Ndërsa sa i përket arsimit, Krasniqi tha se kryefjala për këtë

Qeveria e Shqipërisë premton rreth 70 milionë euro ndihmë ekonomike

TIRANË, 29 DHJETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka njoftuar të enjten se qeveria po mbyll paketën e mbështetjes për 1 milion individë për t'i zbutur efektet e inflacionit. Përmes një postimi në "Facebook", Rama ka bërë me dije se pjesë e paketës së ndihmës prej 8 miliardë lekësh [rreth 70 milionë euro] do të jenë pensionistët, familjet në ndihmë

ekonomike, nënat kryefamiljare, paraplegjikët, tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara, invalidët e punës, por edhe punonjësit e shtetit. Ai shtoi se me këtë paketë synohet të zerohet inflacioni mbi konsumin bazë për kategoritë e sipërpërmendura. "Gëzuar! Qeveria po mbyll Pakon e Madhe në mbështetje të 1 milion

individëve për ta lehtësuar ndjeshëm daljen e familjeve shqiptare nga ky dimër i ngarkuar, duke zëruar efektin e inflacionit të luftës mbi konsumin bazë për pensionistët, familjet në ndihmë ekonomike, posaçërisht nënat kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike, paraplegjikët, tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara,

invalidët e punës, po edhe për punonjësit e shtetit - duke dhënë më shumë për ata që fitojnë më pak, por pa lënë askënd pa mbështetje", ka shkruar Rama, duke theksuar se pakoja e madhe, e cila parashihet mbi 8 miliardë lekë në dorë për të gjithë individët e përfshirë, do të shpërndahet e gjitha në ditët e para të janarit. "Kjo është qeveria e shumicës, jo e

disave dhe faktet e shifrat thonë se volumi i mbështetjes financiare të atyre që fitojnë më pak apo të shtresave në nevojë, në vitet e qeverisjes sonë (pa llogaritur fondet masive të rindërtimit pas tërmetit apo të luftës me pandeminë) është disafish më i lartë sesa në tërë qeveritë e mëparshme të marra së bashku", ka shkruar Rama.



sektor në vitin 2022 ishte greva. Krasniqi ka theksuar se Kosova gjatë vitit 2022 ka mbetur pa politikë të jashtme reale. "Në sinkron me presidenten, kryeministrin dhe ministren përkatëse, shteti ynë ka abstenuar nga politika e jashtme, duke e humbur shansin për t'i shfrytëzuar rrethanat e krijuara në fillim të vitit, për ta avancuar agjendën tonë shtetërore. I kemi bërë thirrje me kohë qeverisë për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Partneritet me NATO-n. Për të parën ka pasur iniciativë të vonuar, e cila sot

s'dihet se ku është, ndërsa për të dytën as edhe iniciativë. Aplikimi për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian, ekskluzivisht, ka qenë dhe do të dëshmohej i tillë, vetëm sa për sy e faqe dhe pa asnjë koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë. Në anën tjetër, gjatë këtij viti kur bota po rirreshtohet në vlera e parime, Kosovës nuk i ka ardhur asnjë njohje e re. As anëtarësim në Organizata Ndërkombëtare, asnjë avancim në marrëdhënie bilaterale", ka thënë ai. Ai ka theksuar se një ndër fenomenet

më tragjike të këtij viti ishte largimi masiv i të rinjve nga Kosova. Krasniqi ka theksuar se lista e dështimeve të qeverisë Kurti gjatë vitit 2022 është e gjatë dhe lë në hije çdo sukses eventual e rrethanor që ka mundur të ndodhë e të cilin PDK-ja e ka mirëpritur. Kryetari i PDK-së ka pohuar se ky vit do të mbahet mend për shëndetësi pa ministër dhe përplot skandale. Krasniqi ka theksuar se gjatë vitit 2022 PDK-ja është përpjekur të ndërtojë një pikëpamje të qëndrueshme për atë çfarë i

duhet Kosovës duke orientuar debatin ku duhet si grup parlamentar dhe në kuadër të reformave të brendshme, ka ndërmarrë një numër të vendimeve të cilat kanë fuqizuar dhe rritur partinë brenda dhe jashtë Kosovës. Ai ka theksuar se viti 2022 ishte vit që ka treguar qartë se Albin Kurti nuk ka kurrfarë projekti politik për vendin. "Për më tepër, ai tregoi edhe një gjë: As nuk do e as nuk di të qeverisë, madje po shfrytëzon secilën mundësi duke krijuar kriza pas krizash që të ikë nga përgjegjësia dhe qeverisja. Tash e dimë edhe

se s'mund ta presim qeverisje prej tij. Prandaj, në vitin që po hyjmë, përgjegjësitë tona si parti politike janë edhe më të mëdha dhe do të punojmë edhe më shumë që të jemi në krye të këtyre përgjegjësiave. Ndonëse është e qartë se Kosova nuk ka të ardhme me këtë kryeministër dhe këtë qeveri, Kosova në vetvete dhe shoqëria e saj pa asnjë dyshim se kanë të ardhme të sigurt. Prandaj, duke shpresuar që në vitin 2023 gjërat të marrin kahun e duhur unë, për fund, ju uroj juve dhe gjithë qytetarëve një vit të mbarë!", ka deklaruar Krasniqi.

Reagim i KMDLNj-së

Të bëhen hetime ndaj kërcënimeve që iu bëhen gjyqtarit dhe prokurorit në rastin Pantiq



Më 28 dhjetor 2022 me propozim të prokurorit të Prokurorisë Speciale, gjykatësi i procedurës paraprake në rastin e të paraburgosur Dejan Pantiq, i dyshuar për terrorizëm ia zëvendësoi masën e paraburgimit me arrest shtëpiak duke e arsyetuar këtë vendim si çështje humanitare. Dejan Pantiq mbahej i ndaluar në Jarinje pasi nuk kishte mundësi të transferohej në qendër të paraburgimit kurse EULEX-i nuk pranoi ta transferonte në një qendër të paraburgimit shkaku i sigurisë në ndërkohë që po ky EULEX e transferoi të liruarin Pantiq në shtëpinë e tij, ndonëse nuk kishte ndonjë zhvillim tjetër pozitiv në fushën e sigurisë.

Qartazi, as Pantiq, as Vuçiq e as EULEX nuk donin që Pantiqi të sillej në shtëpi nga policë të Kosovës! Çështja Pantiq u politizua skajshmërisht në dëm të drejtësisë dhe lirimi i tij ishte një marrëveshje politike, e fshehur, e pamoralshme dhe e kundërligjshme, jashtë syve të publikut. KMDLNj e kishte paralajmëruar më herët këtë zhvillim duke deklaruar se serbët nuk do t'i heqin barrikadat pa lirimin e Pantiqit,

jo vetëm të Pantiqit dhe duket se ka edhe kërkesa tjera që nuk janë të qasshme për publikun, as si informatë! Nuk ishte përgjegjësi e institucioneve të Kosovës që Pantiq nuk u transferua në një qendër të paraburgimit, për shkak objektivë gjithësi por as vullnet i ndërkombëtarëve për faktin se nën rrogos zhvilloheshin bisedime kushtëzuese e që rezultuan me zëvendësimin e masës së paraburgimit me një masë më të lehtë, arrest shtëpiak e që në rrethana ekzistuese kur nuk ka asnjë mundësi të mbikëqyrjes së zbatimit të kësaj mase prandaj, Pantiq është i lirë si zogu ndonëse, për sy e faqe i është shqiptuar një masë kufizuese.

Nga aspekti i të drejtave të njeriut, mbajtja e Pantiqit në ato kushte për një kohë më të gjatë se 48 orë, sa zgjatë ndalimi policor, me të drejta dhe mundësi më të pakta se që i ofron qendra e paraburgimit, është në kundërshtim me të drejtat e personave të privuar nga liria. Në rastin konkret mbajtja e ish-policit Dejan Pantiq, në ato kushte arsyetohet me gjendje të jashtëzakonshme prandaj, edhe prokurori si dhe

gjykatësi kanë marrë një vendim të jashtëzakonshëm, në përputhje me rrethanat aq më parë që nuk ka qenë e mundur të ekzekutohet paraburgimi. Pas këtij vendimi, pikërisht ata që bënë biseda të fshehta për arritjen e një marrëveshjeje si të ishin tyxharë, ne juve Pantiqin, ju i hiqni barrikadat, me paraqitjet para publikut kontribuuan që të fillojë një fushatë linçimi ndaj prokurorit të çështjes dhe gjyqtarit të procedurës paraprake, duke i etiketuar si tradhtarë, joprofesionist, të shitur për 2000 - 3000 euro rrogë, që, përveçse është ndërhyrje flagrante në pavarësinë e gjyqësorit, si pushtet i ndarë, në rrethana normale, seriozisht ua rrezikon jetën e tyre dhe familjeve të tyre. Grafitet kërcënuese dhe shantazhuese e rënduan edhe më shumë sigurinë e prokurorit dhe të gjyqtarit të procedurës paraprake duke e intensifikuar fushatën e linçimit që paraqet shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut aq më parë që është edhe vepër penale. Për këtë arsye KMDLNj fton policinë e Kosovës dhe prokurorinë që të fillojë hetimet për këto kërcënime të pashembullta dhe të orkestruara

dhe të gjithë ata që janë pjesë e këtyre kërcënimeve dhe shantazhimit duhet të përballen me ligjin, pavarësisht përkatësisë etnike, bindjeve politike apo postit që e mbanë. Gjyqësori, si pushtet i ndarë dhe me kompetenca të qarta ligjore dhe kushtetuese që garantojnë pavarësinë e veprimit, nuk ka asnjë detyrim t'i japë përgjegjësi kryeministrit, presidentit e as ministrave që thuaja në çdo paraqitje publike ndërhyjnë në punën e gjyqësorit duke e komentuar çdo vendim gjyqësor e deri edhe te caktimi i masës së paraburgimit apo ndonjë mase tjetër kufizuese. Këto ndërhyrje bëhen kryesisht nga pozita e të fortit të politikës, nga posti më i lartë e deri edhe te postet e dhuruara siç janë postet e këshilltarit politik. Janë mekanizmat e posaçëm që masin punën apo mospunën e gjyqësorit pas së cilave edhe ndërmarrin masa të parapara në bazë të standardeve profesionale. Për KMDLNj-në është shqetësues fakti se qytetarët e Kosovës për zhvillime rreth gjendjes në veri, për shkak të territ informativ e sidomos për lirimin e ish-policit Pantiq po informohen nga mediet e

presidentit Vuçiq të cilat edhe paralajmëruan se Pantiq do të lirohet që doli të jetë e vërtetë e që nënkupton se ka pasur një marrëveshje politike të ndërmjetësuar (të urdhëruar) nga ndërkombëtarët.

KMDLNj edhe më herët ka deklaruar se situata në veri nuk do të përshkallëzojë në atë masë të një konflikti të armatosur për faktin se duket se ka qenë një përshkallëzim i menaxhuar mirë. Tash, shtrohet një pyetje, në radhë të parë për ndërkombëtarët; nëse një i arrestuar dhe i dyshuar për terrorizëm, nën trysni lirohet për t'u dërguar simbolikisht në arrest shtëpiak dhe i cili nesër mund të jetë pjesë aktive e ndonjë barrikade, pse atëherë mbahet në paraburgim Bratislav Nikoliq, i akuzuar për mitmarrje dhe shpërdorim të detyrës zyrtare i cili i ka të përfunduara hetimet, ka aktakuzë të konfirmuar, ka filluar gjykimi dhe se sipas të dhënave të prokurorisë që dolën në media përkohësisht i ka të sekuestruara 1 milion e 300 mijë euro e që është peng më se i mjaftueshëm, çfarë logjike juridike ka këtu dhe cili ka më shumë motiv dhe mundësi të ndikojë në proces apo të largohet nga Kosova?! Që të dy janë serbë të Kosovës e që në të njëjtën kohë e kanë edhe shtetësinë e Serbisë. KMDLNj me këtë krahasim vetëm e vë në pah se sa ndikojnë në vendimmarrje ndërhyrjet politike si dhe presioni i opinionit i cili, në rastin Pantiq vendimmarrja u kushtëzua me heqjen e barrikadave.

Ndërkombëtarët, me këmbënguljen për lirim të Dejan Pantiqit duke bërë trysni te politikanët e vendit dhe gjyqësorë vetëm sa po e inkurajojnë forcimin e paligjshmërisë në atë pjesë të Kosovës sikur edhe po e forcojnë rolin dhe ndikimin e Vuçiqit në Kosovë. Prania e institucioneve të Kosovës në Veri është simbolike kurse e Serbisë është faktike që duhet të mobilizojë pozitën dhe opozitën dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. KMDLNj është shumë e brengosur që në Kosovë po mungon aktivizimi qytetar i cili duhet të jetë opozita e vërtetë dhe se është krijuar një situatë letargjike.

Shqiptar Demaçi përkrah lulëkuqen për simbol të gjenocidit në Kosovë

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Djali i veprimtarit Adem Demaçi, Shqiptar Demaçi, i ka dhënë përkrahje propozimit të Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", që lulëkuqja me

katër petale të jetë simbol për kujtimin e gjenocidit në Kosovë. "E mbështes propozimin që lulëkuqja në logo të simbolizojë gjenocidin e kryer të forcave serbe në Kosovë!", ka shkruar

Shqiptar Demaçi në "Facebook". Një ditë më parë Kuvendi Komunal i Skenderajt, i Gjakovës, i Rahovecit, i Vitisë, i Kaçanikut dhe i Deçanit kanë përkrahur kërkesën që lulëkuqja

me katër petale të jetë simbol i përkujtimin të gjenocidit në Kosovë. Kjo iniciativë deri më sot është duke marrë përkrahje të madhe nga e gjithë shoqëria në Kosovë.



Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Haxhiut: Nuk e përkrahim një veting të tillë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka folur për vetingun në sistemin e drejtësisë në një konferencë për medie të enjten. Ai ka thënë se kanë pasur takime të ndryshme me faktorët e pushtetit dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kur është diskutuar për këtë çështje. Maloku ka bërë me dije se nuk e mbështesin këtë proces të vetingut të paraqitur nga ministrja Albulena Haxhiu. Kjo pasi, sipas tij, nuk i sjell dobi as sistemit të drejtësisë e as qytetarëve të Kosovës. “Ju e dini, ne kemi qenë aktivë prej fillimit në grupet punuese që i ka formuar Ministria e Drejtësisë. Kemi pasur përfaqësuesit tanë aty. Kanë qenë aktivë. Edhe në takimet e drejtpërdrejta me ministren e Drejtësisë apo faktorët e tjerë. Nuk

e përkrahim një proces të vetingut klasik pasi ka më shumë pasoja sesa që i sjell dobi KPK-së. Nuk e di çfarë dobie i sjell qytetarit një veting që më tepër ka më shumë pasoja sesa dobi. Nuk jemi dakorduar për një veting të tillë”, ka deklaruar Maloku në konferencën e fundvitit për medie, ku ka prezantuar veprimtarinë njëvjeçare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, rezultatet dhe sfidat me të cilat Këshilli është ballafaquar për realizim të mandatit të tij si dhe planifikimin për vitin 2023. Kryesuesi Maloku me këtë rast ka thënë se KPK-ja këtë vit ka mbajtur 18 takime dhe ka nxjerrë më shumë se 180 vendime të cilat kanë shërbyer për realizimin e mandatit të tij ligjor dhe në shërbim të sistemit prokurorial. Për më tepër, sipas tij, Këshilli ka realizuar edhe takime të tjera të shumta përmes komisioneve të veta të përhershme, ad-hoc dhe

trupave të tjerë. “Me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë, KPK gjatë kësaj periudhe ka hartuar dhe miratuar Planin strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024. Ky plan paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës në tre vjetët e ardhshëm. Këshilli gjatë vitit 2022 ka hartuar dhe miratuar pesë rregullore të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e lëndëve përmes sistemit elektronik, zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të drejtorit të Sekretariatit dhe atij të Njësitit, rekrutimin, provimin, emërimin dhe rrimërimin e prokurorëve të shtetit, përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe praktikantëve. Për më tepër, Komisioni për Çështje Normative ka filluar aktivitetet e veta nëpër prokuroritë e Kosovës për ta vlerësuar zbatueshmërinë e

akteve nënligjore në fuqi”, ka thënë Maloku. Ai ka theksuar se Këshilli Prokurorial i Kosovës është në proces të riorganizimit të administratës së sistemit prokurorial me qëllim të ngritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit në punë. “Gjatë periudhës raportuese, Këshilli ka zhvilluar të gjitha procedurat për zgjedhjen e kryeprokurorit të shtetit dhe kandidatit më të suksesshëm e ka propozuar për dekretim te presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë proces, Këshilli ka publikuar konceptdokumentet e të gjithë kandidatëve, kurse intervistat janë zhvilluar në prani të përfaqësuesve të OJQ-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë si dhe janë transmetuar në mediumin publik - Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), i cili mundësoi që secili qytetar të përcjellë këtë ngjarje të rëndësishme në

sistemin e drejtësisë”, ka thënë ai. Maloku ka thënë se në muajin prill Këshilli ka rekrutuar shtatë prokurorë të rinj dhe ata janë dekretuar nga presidentja dhe kanë filluar punën në prokuroritë përkatëse. “Po ashtu, në muajin qershor 2022 Këshilli ka hapur konkursin tjetër për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj dhe deri më tani janë mbajtur dy testet dhe intervista, ndërsa është shpallur lista me emrat e 22 kandidatëve më të suksesshëm të këtij procesi dhe, pas miratimit nga Këshilli, këta 22 emra do të dërgohen për dekretim te presidentja. Këshilli, përmes rrugëve ligjore, ka avancuar tre prokurorë dhe transferuar tetë të tjerë nëpër prokuroritë e Kosovës, ndërsa në punë janë edhe dy procese për avancim për katër prokurorë. Disa prej objektivave të Këshillit për këtë vit kanë qenë: llogaridhënia, profesionalizmi dhe disiplinimi i prokurorëve”, ka theksuar Maloku.



Ministri Mehaj i fton qytetarët të kontribuojnë në Fondin e Sigurisë

Prishtinë, 29 dhjetor - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, i ka ftuar qytetarët të kontribuojnë në Fondin e Sigurisë për FSK-në. Ai ka thënë se nevojitet mbështetja qytetare për ta konsoliduar Forcën e Sigurisë së Kosovës në nivelin e ushtrive anëtare të NATO-s. “Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës nuk janë duke u trajnuar thjesht për lavdi. Atyre nuk u intereson sa medalje fitojnë, apo sa herë i shohin emrat e tyre në televizion apo në portale. Ata janë atje, në kazermë, në teren, çdo minutë të çdo dite, duke u angazhuar për atë që besojnë. Trajtohen e ushtrijnë që niveli i tyre i

përgatitjes të jetë i lartë, aq sa edhe vullneti i tyre për ruajtjen e paqes dhe garantimin e sigurisë për familjet e tyre dhe kombin në përgjithësi. Ne të gjithë duhet të jemi shumë krenarë për ta. Por të jesh krenar nuk mjafton. Duhet të kujtojmë se ata kanë nevojë për mbështetjen tonë”, ka thënë Mehaj.

Ai ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës përgjatë këtyre 19 muajve ka investuar më shumë se çdoherë tjetër në avancimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. “Ushtrakët tanë në vazhdimësi janë duke u pajisur me armatimet më moderne ushtarake, ndërsa

oficerët e rinj po shkollohen në akademitë më të njohura botërore”, ka deklaruar Mehaj. Mehaj ka theksuar se mërgata, pronarët e bizneseve, por dhe qytetarët e thjeshtë të këtij vendi, shtresa e mesme e shoqërisë për nga të ardhurat, por e lartë nga atdheadashuria, gjithmonë kanë qenë mbështetja më e madhe për çfarëdo lëvizje në mbrojtje të atdheut. “Sot, gjersa kemi ushtrinë dhe Republikën, na duhet mbështetja juaj për ta konsoliduar Forcën e Sigurisë së Kosovës në nivelin e ushtrive anëtare të NATO-s, kështu vlerat demokratike të shtetit tonë mbrohen dhe jeta



e çdo qytetari është e sigurt. Prandaj, ju ftoj të kontribuoni në Fondin e Sigurisë për interesat shtetërore, për forcën

që do ta mbrojë atdheun, do ta sigurojë jetën tuaj dhe të ardhmen e fëmijëve”, ka thënë Mehaj.

ATK-ja inkasoi 721 milionë euro

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka paraqitur të arriturat dhe sfidat e vitit 2022. Zëvendës drejtori ekzekutiv i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se vitin 2022 do ta karakterizojë tejkalimi i të gjitha parashikimeve në mbledhjen e të hyrave për buxhetin e shtetit, të cilat shënojnë 721.6 milionë euro, që i bie se, përveç realizimit të planit për këtë vit, ATK-ja ka arritur të inkasojë mbi 10 milionë euro më shumë se plani i rishikuar. "Rritje dhe tejkalim të të hyrave kemi edhe nëse krahasojmë këtë vit me vitin 2021, ku shifrat shkojnë në 124 milionë euro. Mbledhja e të hyrave nuk është i vetmi indikator që ATK-ja ka shënuar progres këtë vit. Progres ka edhe në trajtimin e borxheve tatimore, tek të cilat është arritur të kemi 152.2 milionë euro borxh të mbledhur. Veç kësaj, këtë vit

janë ndërmarr një numër i konsiderueshëm i aksioneve për konfiskim të borxheve ndaj tatimpaguesve, të cilët nuk i kanë respektuar afatet dhe kushtet për t'i kryer obligimet tatimore", ka thënë Murtezaj.

Ai ka thënë se fokusi i ATK-së këtë vit ka qenë me theks të veçantë edhe në përmirësimin e përmbushjes tatimore në sektorët të cilët, sipas analizës së riskut, kanë paraqitur hendek tatimor. "Për të pasur rezultat ATK-ja ka punuar që të ketë trajtim sektorial përmes pesë projekteve të cilat janë duke trajtuar sektorin e ndërtimitarisë, punësimit joformal, gastronomisë dhe hotelerisë, mallit pa dokumentacion/mungesa në stoqe, si dhe mosdeklaruesit", është shprehur Murtezaj.

ATK-ja gjatë vitit 2022 u vlerësua lart për performancën e saj nga të gjitha institucionet ndërkombëtare të cilat bëjnë



monitorimin e punës së ATK-së, sikurse raportet e vlerësimit nga: FMN-ja, raporti i KE-së, OECD-së, USAID si dhe vlerësimet nga Ambasada e

Britanisë së Madhe dhe institucionet e tjera.

Në kuadër të këtyre informacioneve, drejtori i ATK-së ka përmendur hetimet

që janë kryer karshi monitorimit të rrjeteve sociale përmes veglës analitike të cilat është konstatuar 1.9 milion euro qarkullimi shtesë.

Studentët: Patriotizëm në liri është t'i bojkotojmë produktet e Serbisë



PRISHTINË, 29 DHJETOR - Me plis në kokë dhe me pankartat "Dua je tënden", "Ata barrikadojnë rrugët, ne barrikadojmë ekonominë e tyre", "Mos e forconi armikun", është mbajtur të enjten protestë paqësore "Bojkoto produktet serbe", e cila u organizua nga studentët e Fakultetit të Edukimit.

Studentët derisa marshuan bënë thirrje nga të gjithë që t'i bojkotojnë këto produkte serbe. Sipas tyre, duhet të ngrihet vetëdijesimi i popullit për ta ndaluar blerjen e produkteve të Serbisë dhe të konsumojnë produktet e vendit në mënyrë që të fuqizohet ekonomia e Kosovës e jo ajo e Serbisë.

Laurita Terpeza, studente e Fakultetit të Edukimit, tha se duhet kujtuar atë që ka kaluar populli i Kosovës për shkak të

Serbisë dhe duhet të ndalohet blerja e produkteve të Serbisë. "Arsyeja që kemi organizuar këtë marshim paqësor është që të kujtojmë atë që ka kaluar populli ynë, ku ne deri më tani kemi ushqyer armikun tonë me duart tona. Andaj, U bëj thirrje gjithë shqiptarëve anëmbanë botës t'i bojkotojnë produktet e Serbisë. Më mirë të rrimë pa ngrënë se të ushqehemi nga helmi i tyre. Më mirë të fokusohemi te produktet vendore, ta fuqizojmë shtetin tonë, ushtrinë tonë dhe jo atë të serbëve", ka theksuar Terpeza.

Yllëza Murtezi, po ashtu studente në Universitetin e Prishtinës, tha se patriotizmi në liri është që të bojkotohen produktet serbe pasi, sipas saj, me blerjen e tyre po fuqizohet Serbia.

Ministrja Hajdari dënohet për mosdeklarim të pasurisë

PRISHTINË, 29 DHJETOR - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, është dënuar me gjobë prej 700 eurosh nga Gjykata Themelore në Prishtinë për shkak të mosdeklarimit të pasurisë për vitin 2020 brenda afatit ligjor, ka bërë me dije përmes një njoftimi gjykata. "E akuzuara R. H. [Rozeta Hajdari] është shpallur fajtores dhe është dënuar me gjobë në shumën 700 euro, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim

të bëhet i plotfuqishëm", thuhet në njoftim.

Sipas gjykatës, Hajdari, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, si ministre e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike në Qeverinë e Kosovës, duke qenë e vetëdijshme për detyrimin e saj ligjor, nuk e ka deklaruar pasurinë ashtu siç e kërkon Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë.

Hajdari kishte pranuar paraprakisht fajësinë para gjykatës duke thënë se ishte krijuar konfuzion pasi ishte shtyrë afati për deklarim të pasurisë së zyrtarëve publikë.

Më 14 tetor të këtij viti Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte ngritur aktakuzën ndaj ministres Hajdari për veprën penale "Mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare".



BISEDË ME HYSEN TËRPEZËN (5)

Serbia nuk e lëshon [Kosovën] me paqe

Ushtarët çka bënin aty kur i morët me vete?

– Jo, aty s'kish partizanë hiç. Nja katër a pesë s'luajtën hiç prej aty. U tha Alia mos luani ju. Këta të mitë ishin tubë me ne. Kur u avitem aty, ndaluni u thashë. Jo, zotni Tërpeza, do të të çoj te shokët. Ngadalë, jo, jo, i thashë, s'ka nevojë. Unë e marr zotni Shabanin e zotni Brahimin. Këta do të vijnë me mua në mal. S'po i lë të presin. Tha aty: unë do të të ndjek e ti bëj çka të duash!


Alia?

– Po, mua më tha Alia. Hajt, i thashë, ju bëjeni tuajën e unë timen. Udha e mbarë! Mbarë paç! I morëm Shabanin e Brahimin. Perëndoi dielli. Shihej nga pak hala. Ecnim nëpër lëndinë. Na jemi shqiptarë, njerëz si të egër. Po donë t'i ndalin edhe Shabanin e Brahimin, të mos i lënë të hyjnë në mal. Ndaluni u thashë. Ata u ndalën. Po shuajnë. Po tuten. Hakiu e nxori alltinë, po qet bam-bam. Ata këqyr. Alia mbeti me ata që mbetën atje. Na pa. U bë bërlllok. S'më erdhi mirë hiç! Kanë kujtuar mos i vramë ata. Unë po çuditem. Kur tha mendo për familje, për farefis. Qaty, thashë me vete, këta i kishin prerë të dy djemtë, se njëri ish më i madh, tre-katër vjeç. Po pritni, bre, se nuk qitet fare Kosova.

E çohet Rugovë zeza e thotë tash, unë bëra një punë për ta shpëtuar familjen. Mua dikush po më jep nga pak vërejtje. A di kush, ata që nuk e kanë humbur asnjë? Mua më kanë pyetur edhe amerikanët. Po thosha, babën e babagyshin ia kanë vrarë për një natë. Kam dëgjuar ashtu. Komunizmi. Po tash të thotë ky burrë zeza ashtu. Edhe gruan time e kanë çuar në burg në Gjilan e në Ferizaj, s'kam thënë asgjë.

E ke ndarë mendjen?

– E kam ndarë mendjen, le ta çojnë, le ta burgosin. Ne, kur jemi nisur për Greqi, jemi nisur në muajin e fundit. Prej maleve të Kozmaqit. Ishim shumë. Një vëlla qe plagosur e një qe vrarë në vend. Vëllai i plagosur jetoi nja 15 ditë. Aty ishim nja 300 veta. Unë e dhashë një fjalim. Thashë: vëllezër, do ta lirojmë këtë popull. Shtet s'mund po bëhemi. Këto pushkë që i kemi prishur, i gjejmë në Evropë.



Njëmend kish qenë ashtu. Thashë e lirojmë këtë popull e do të dalim. Unë, edhe po të mbetem me dhjetë veta, s'ndalem. I kam ditur udhët shumë andej. Kam pas bartur duhan nga Maqedonia.

Gjatë asaj kohe, a e dinit ku ishte mulla Idrizi?

– Jo, u këput lidhja. Mulla Idrizin e patën kapur në Përlepnice.

Ai kish qenë i strehuar një kohë të gjatë në Gjyryshec.

– Qe këputur lidhja. Veç dikush na pati treguar se i gjallë është. Na dhimbsej i shkreti. Patriot i madh. Taktikë lufte nuk kishte. Nuk ishte zanat i tij. Bile, kur kam qenë në Preshevë, ishin Sulë Hotla e Hamzë Bellanovci, do pari krejt, dolëm e dhamë një fjalim aty. E thyem luftën. U pa puna.

Më 1945 patëm marrë vendim ta lëshonim Kosovën. U ndamë. E lamë amanetin te

shtëpia. Do kënde, intelektualët, veç Ibrahim Kelmendi ishte me mua, Ademi dhe Limani ishin andej, në Ferizaj, nga ana e Jezercit, për të mbledhur dikë, që t'i tërheqë prej Kosove. Unë rashë në pritë. M'u vranë kushëri dhe vëllai. Kishin dëgjuar ata. I kishin çuat dy veta. Një Kërstiçi ka qenë me ne në mal. Zahir Kërstiçi, edhe një tjetër. Ademi e këta thonë, shko thoni çka të bëjmë. Thashë ju nisuni e shkoni! Për mua mos u bëni merak. Unë kam shokë boll. Unë kam njerëz që vijnë. I kam edhe 300 njerëz aty. Vëllai ishte sëmurë. Ata kanë shkuar. Kanë qenë kallaballëk. Kanë qenë treqind-katërqind veta. Po çka të bëjmë? Kanë mandat t'i bien nëpër tokë të Shqipërisë, të dalin më shkurt në Greqi. Kur kanë hyrë në tokë të Shqipërisë, i kanë rrokur brigadat shqiptare e janë kthyer prapë. Unë jam nisur 5-6 ditë mbas tyre. Një ditë para tyre kam

hyrë në Greqi. Në kufi rashë në pritë. M'u vranë dy veta. Unë jam dorëzuar sikur sonde në aksham, ata para sabahut të nesërmen. Ademin e kanë pyetur. Ata po e dinë që unë jam në mal hala. Kë keni në mal? E kemi komandantin Hysen Tërpeza. Ai është komandant i përgjithshëm, e ka dhanë deklaratën. Ai prej Shkupit deri në Mitrovicë i ka 15 mijë veta. Pesë mijë i ka ilegalë, të tjerët janë maleve. Edhe prej Shkupit e në Mitrovicë i ka zaptuar ato katunde. Kur të nesërmen u takuam, ne u përqafluam. Do të kishin humbur, do të kishin ikur e do të kishin hyrë në Shqipëri. Shumë janë kthyer prapë në Kosovë. Mozomakeq, bre! Mas dy dite shkroi gazeta. Ademin e ka pyetur. Çka kanë pyetur Ademin, çka ka shkruar gazeta. Hysen Tërpeza komandant e kështu. Kur të nesërmen u takuam, edhe gazeta doli. Grekët afër kufirit

dinin serbisht e shqip. Erdhën pastaj mbas nja katër-pesë dite prej Athinës të na pyesnin. Qeveria e Athinës. Tre, këta intelektualët, edhe unë katër. E kishim gazetën në dorë.

Emrat?

– Çka je – Ademit – me shkollë? Ibrahim Kelmendi, profesor i historisë. Luan Gashi, po ashtu. Po ti? Unë bujk. Emrin? Hysen Tërpeza. Po kanë keni komandant? Ademi u kthye e i tha e kemi Hysen Tërpezën.

Emri Bajraktar shumë i madh ish në Greqi. Ish me famë. Kishte aty Kristo Bajraktari, Nikoll Bajraktari... Asnjë derë nuk i ndalte ata. Tha ky është shtëpi bajraktari. M'i rrahu krahët. Ata u tutën mos po i kap diçka, si shkollarë që ishin. Pastaj s'i lyppte kush. Na çuan në Athinë, ashtu krejt. U bëmë shumë. Treqind e sa prej Maqedonisë. Njëri e kish pasur një krah me letra. Na bënë rend. Po shoh nja 14-15 veta janë ndarë.

Këta tre intelektualë e Qazim Llugaxhiu e kishin nga një vëlla a kushëri me vete. Kanë dalë nja 15-16 veta, kanë mbetur në fund atje. Këta e dinë qysh unë e lypni. Kur më lypën mua, i qitën në krahë këta të ministrisë atje. Atëherë e lypën kë e keni pasur komandant të përgjithshëm? Hysen Tërpezën. Atëherë Ademi, pasi pa se i akuzonin, i tha: nuk kemi pasur komandant, por kemi luftuar me çeta. I vetmi që kish dhënë deklaratë për gazetë. Më nuk e pyeti kush. Mbetën ashtu. Hala kësaj i tutna, bre mixhë! Hala kemi hile. Qe 53 vjet Ademi nuk ka folur me mua. A unë e kam ndjekur pas kudo. Zoti Adem, ndalu, bre! Zoti nja...

Adem Gllavica?

– Po, Adem Gllavica. Veç t'i dalë emri. Po Serbia e kish emrin tim, Hysen Tërpeza. Në gazeta tani veç unë Hysen Tërpeza. Ai që ka nisur t'i rrëzojë tri shtete, Bullgarinë, Serbinë, Shqipërinë. Pastaj kanë ardhur krejt gazetarët e Evropës e të Gjermanisë e më kanë marrë. Kish aty përkthyes shqiptarë. Një përkthyes po thotë fol, zotni Tërpeza, e thuaju çfarë grade ke. Thuaju a veç ata me grada luftojnë a? Një ditë shkollë s'e kam, po jam shqiptar e luftoj. Kanë luftuar shqiptarët 1840 vjet. Edhe unë

luftoj për kombin, i thashë. Edhe sot më fort mendojnë t'u dalë emri se jo çka kanë bërë.

Sa kohë ndenjët në Greqi?

– Në Greqi ndenjëm katër vjet.

Gjatë asaj kohe si silleshin grekët me ju?

– Mirë. Na çuan pak në Gjirit. Ishim në një kamp afër detit aty. Ishin edhe të Shqipërisë së vjetër, nja 600 veta. Ka pasur edhe amerikanë. Kishte edhe austriakë aty. Serbët kishin bërë përpjekje që t'i bindnin se këta njerëz janë të Jugosllavisë e t'i mbajnë vetë. Edhe grekët ia mbanin anën Serbisë. Komandanti i kampit kish qenë i sertë. Na kanë mbledhur tubë ne. Çka jeni? Unë u thashë kosovarë shqiptarë. Mos rrimi me serbë. Besa filluan të ndaheshin disa. Ish përkthyes një Sejdi Banja. E ditke ai greqishten si ne serbishten, në kufi me grekë. Dikush kish thënë se ky është ai që po kundërshton. E unë i thashë ne nuk jemi serbë, po jemi shqiptarë. Ne nuk rrimë me serbë. I kishin çuar disa me serbë në Amerikë. Në një vend i kishin çuar, se janë jugosllavë. U mrrol ai, se kish qenë i sertë. Më tha mos bëj propagandë këtu.

Më tha a ke lind aty në Jugosllavi? Ti je jugosllav. Çka do ti? Do të shkosh me jugosllavë. Bre, bëhet, bre s'bëhet. Unë i thashë: Zotni, thuaji zotni komandantit a je grek ti? Tha po. I thashë unë jam shqiptar. Atëherë qenkan gjermanë. I thashë kam lindur në Jugosllavi, po ajo asht tokë imja. Sikur ty që të ka lindur

nëna këtu. Bërtiti e tha ndahuni ju shqiptarët. Unë i kam tërhequr ata që kanë shkuar përpara në Greqi. Ademi tha na e humbi Kosovën. Tha duhet të themi ne jemi Jugosllavi, po në tokë tonën e duhet të lirohemi. Po së pari duhej thënë je shqiptar. Shumë kanë gabuar. Ty nuk të lëmë të shkosh nga Gjiriti. Unë isha shkruar komandant. Atje tha njerëzit punojnë me kazma. I thashë me këta njerëz do të shkoj, me kazma, me kazma. Në borë e në shi. Po të mos ishin këta njerëz, unë nuk isha gjallë. I telefonoi Tiranës. I paskan thënë, ky nuk ndalet, veç nëse e vrisni. Kur shkuam atje na ndanë. 28 veta, krejt kosovarë, kemi qenë në një japi. Ajo shtëpi ish dy kate. Po kati i epërm ishte mbyllur. Kati i poshtëm ish i madh. Nuk di, veç zoti na shpëtoi, se atje toka kish qenë krejt pa punuar. E kishin minuar fushën e nuk guxonin ta punonin. Grekët mbyteshin përditë nga minat, po asnjë shqiptar nuk u mbyt. Shkonin e punonin. Ka bërë vaki i ka rënë bombës me kazmë, po nuk ka krisë. Nafaka. Pas pak kohe i kam vizituar edhe të Shqipërisë e të tjerët, 800 veta. Kishte ardhur një hingliz, gjeneral Krispi, a nuk di. Ai kishte ardhur prej Prishtinës e me ka lypur mua aty. Erdhën të më merrnin. Erdhi urdhri. Grekët po duan të na mbysin. Mileti u ngrit krejt. Më thirrën mua. Erdhën dy automjete me policë, hajde se nesër në sabah po të lypin diçka. Na kanë ruajtur shumë. U dashke me vapor të shkonim diku. Unë i lashë shokët e mi

krejt. Hipëm në vapor. Larg është. Kur shkova atje ishin edhe 700 veta të Shqipërisë. Ishin krejt paria, këta të Ballit ishin. Kështu, duke u shtyrë ndër vete, ai parti, ai tjetri parti. Mithat Frashëri ishte në Itali. Abaz Ermenji ishte aty. Po ish lidhja me ta. Ky që ish aty, po thotë, veç ai dhe unë, e tjetër nuk ka aty.

Abaz Ermenji ishte Balli, a?

– Po, kryetar i Ballit. Njëherë, me të rri pak, e mandej të çojmë në kamp. Paria krejt ish aty. Ata e kishin një odë veç aty. Ermenji ishte aty. Mua më ka kolovit shumë, por e pashë që ish shumë gabim. Ai komandanti i policisë aty po më thotë: Ti po shkon në kamp, po mos u përziej fort në politikë.

Ty po të thotë?



– Po. I thashë politika ime është kundër komunizmit. S'kam tjetër politikë. Nejse, kur shkova dolën e më pritën mua. Muharrem Bajraktari, Përvizi e shumë të tjerë. Të të gjitha partive. Edhe Abaz Ermenji, mirë më priti mua. U thashë u bë mirë që u shkolluat e nuk jeni më me ato mend. Unë shoh. Jeni tash tjetër. U thashë jepni zor, se do të na i mbytin shokët atje. Mua, a po më shihni. Unë kam fjetur në vreshta të rrushit. Mua ma dinin emrin. Më thirrshin me emër. Ka zot. Prapë i ri isha. Ai Ermenji i tha Bajraktarit, shih çka tha zotni Tërpeza. Ama unë i vizitova krejt. Edhe ata të Shqipërisë i kam vizituar krejt. Ai vend është i madh, sa prej

Kosove me Shkup e me Kumanovë. Në Gjirit ka vdekur një djalë i hallës. Ne na shpërndanë. Ai ka qenë në tjetër vend. Duke shkuar në punë, një oficer i veshur, e paska njohur, Bajram e ka pasur emrin.

Këtij i paska pas mbetur buka në fyt kur ka qenë tek unë. Ky me ata tre patën ndenjtur në shtëpinë tonë tri net. Po thotë ai oficeri: në shtëpi të këtij njeriu më ka pas mbetur buka në fyt. Unë nuk e njoha, se atëherë ka qenë në tesha civile. Tash ishte me tesha ushtari. Ai e pyeti Bajramin ku është ai (për mua). Ia jep adresën. Pastaj ai më lypoi mua. Unë dija të shkoja, po ka ardhur një oficer tjetër, një Krispi, anglez. Njëherë anglezët e humbën luftën, po mbasandaj kanë bërë punë.

Vallahi, u tha Abaz Ermenji, ashtu sikur jemi këtu. Po i thotë Muharrem Bajraktarit: Zotni kolonel, a po dëgjon çka po thotë zotni Tërpeza: na i mbysin shokët. Çohu e shkojmë në Ministrinë e Jashtme e le të japin urdhrin le të na shpëtojnë shokët. Ai po thotë e di vetë unë! U dukej sikur po u bie vlefata nëse shkon në çdo derë. Ta bëjmë një letër e të shkojmë bashkë. E kemi edhe zotni Tërpezën me vete. Ka qenë njëfarë Qirka avokat. E njihnin të gjithë atë grekofil. Po shqipen e ditke perfekt. E kuptova unë mirë pse nuk po shkon me kallaballëk Bajraktari. Se po i bie poshtë emri nëse shkon me kallaballëk. Thotë, vetë jam unë.

Të nesërmen u avit Ermenji. Zotni Tërpeza, çohum se po të shoh që ti po përpiqesh, e marrim avokatin Qirka e shkojmë në ministrinë. Shkuam, e morëm avokatin menjëherë. Kur kemi hyrë në Ministrinë e Brendshme, deshi Zoti nuk qe aty ai greku që e njihja nga Kosova, se kish qenë oficer i shtatmadhorisë, ka shkuar në krahina të tjera. Të kish qenë aty ai do të kishte treguar sa shokë tanë janë vlarë për ta shpëtuar oficerin e tyre. Ai ka thënë se shqiptarët i kemi komshi e kanë luftuar për ne. Ai thotë se turp është për ne t'i lëmë e t'i vrasin atje shqiptarët. Dha urdhër shteti e i prunë krejt aty. Në një vend ku ishte Adem Gllavica, ishin 50 kosovarë me të. Kam shkuar. Nuk ka ardhur të takohej me mua. Kanë qenë do të Okllapit, Jetishi e Rexhepi. Unë i pyeta qysh është zotni Ademi? Fola mirë për të. U thashë këtyre se ishin shumë që punonin, ju t'i jepni nga pak drahmi Ademit të gjithë. Ai është intelektual, bre. Thoni Ademit se ai Hyseni po mendon edhe për ty, po nuk erdhi. Aty më ndalën e më kanë bërë shumë muhabet. Ai njeri që do të bëjë veç emër kujt i duhet. Pse mbeti vetëm. Pastaj u martua me një gjermane. Ibrahim Kelmendi u martua me një angleze. Luan Gashi u martua me një greke. S'ka pyetur më kush për ta. Unë, nuk është për të thënë para burrave, më nuk kam qenë për femra, se jam prishur. Doktorët ma kanë tërhequr vërejtjen. Isha i shëndoshë, por mos të marrohem, isha prishur. Po



s'jam pishman. Punë e madhe, gjallë jam!

Sa ishit në Greqi a e takove?

– Po. Në Athinë e takova.

Mbasandaj a jua dha krahun?

– Po, po. Na ka ndihmuar. Pastaj mua më bëri edhe politika më të njohur. Mua për të ma dhënë emrin më të madh, ma dha Jugosllavia. Duke më akuzuar, ma dha emrin e madh.

Mbas katër vjetëve, ku ju qitën?

– Na çuan në Itali.

A krejt komplet, a veç e veç?

– Jo. Krejt komplet. Do i çuan në Gjermani. Në Itali u bë Komiteti...

Terpezë, tha, të kam thirrur dhe po flet me sukses. Do të takohesh në një mision me shumë sukses. Hajrli qoftë! Unë e kisha marrë vesh pak. U ngushtua situata shumë. Në çdo mënyrë Amerika vendosi ta bënte punën e vet. Amerikanët u munduan që edhe mua të më bindnin, por unë u thashë se me serbët nuk punoj. Abaz Kupi kishte një emër. Nënkyetar i Komitetit edhe ai. Po më vjen turp ty me të thanë bre. Kur më ka thirrur, më tha: Tërpezë, do të ngarkohesh me një mision, do të shkosh në Beligrad. Tybe istikfa. Do të takohesh me Titon. Gojarisht do të bisedosh. Do të të presë mirë. Tha, ta përzëmë këtë farë bërlloku e ta shkelim. I thashë unë pranoj vdekje njëqind herë, se një herë të vdesësh nuk është kurrëgjë. Njëqind herë të më vrasin e të më ngjallin, të më vrasin e të më ngjallin, me terror nuk pranoj. S'ka nevojë të më garantojë kurrkush. Mua le të më presë Tita me ushtri. Le të ma qesë ushtrinë, po le të më shëtitë nëpër krejt Kosovën. Unë jam betuar. Unë dua të vdes me nder. U prisha unë me ta. Mandej as nuk flisja kurrëgjë. Unë e kisha kuptuar, çka kishin ndër mend. Të marrin ushtrinë nga të gjitha, nga Sllovenia, nga Kroacia e krejt t'i përziejnë aty. Këta të Shqipërisë, i kishte 6-7 vjet që më kishin kapur mua. Hajde se ti kishe qenë patrioti më i madh. Ju kosovarët e kishit pas njohur serbin e ne jo. Në Evropë kam qenë dy herë. Hajde ti e bisedojmë, se Kosova do të bashkohet për 50 minuta me Tiranën. U hap fjala se unë nuk luftoj për ide, por për komb. Edhe njëmend ashtu ishte. Unë nuk pranoj. Çka ka bërë, kur dhashë dorëheqje unë, se u prish puna krejt, u hallakat. Shqipëria ka rënë në kontakt me Kosovën. Ne nuk mund ta mashtrujmë. Ju mund ta mashtroni po i thatë që

Kosovën e bashkojmë me Shqipëri, por ai me serbë nuk punon. Qysh doni të jetë me ju, kur ai me serbë nuk punon. M'u tekën mua ata! Kishin shkuar 7-8 vjet.

Kisha dëgjuar me fjalë se pa i rënë lumit, s'mund ta kalosh. Me frikë s'mund e kalon, po mbytem a po mbytem. Më kishin bërë një pasaportë. Merre pasaportën amerikane, se në Athinë po duhet të shkosh. Andej e kam pasaportën unë, kishe jam prej Shqipërisë. Pritja aty ishte madhështore.

Me çfarë emri shkove?

– Me tjetër emër.

A e mban mend emrin?

– Jo, ebu! Çka po të duhet? Mos hyn aq thellë! Unë, kur shkova në Athinë, ishte natë, ora nëntë e gjysmë. Me pasaportë amerikane hipa unë. Hala pa zbritur, pasaportën amerikane e futa në kundër. E kallëzoi atë tjetrën, që është false. Në Janinë ishim.

Në vitet '80 ka qenë a?

– Po. Para të '80-tave! Një ditë pa shkuar unë, i kishin pas përzënë edhe kinezët nga Shqipëria. Më kallëzoi njëri. Tha dje janë hequr kinezët. Më çuan në një hotel, po ia kishin hequr ato shkronjat. Ish ajo ndërtesë tre-katër kate.

Po në paça fjetur, më sa ju në paçi ardhur atëherë aty! Më hyri një frikë e madhe. E kisha pasaportën amerikane, ama po bëhen marri, isha gati 90 vjeç. Thashë, në dorë të zotit! Shkova me taksi në aeroport, por tha vonohet dy orë avioni. E lashë aty një valixhe të vogël. Po sillem aty, se mua më njohin emigracioni sikur paren e kuqe. Aty ka plot kosovarë e të Shqipërisë, të martuar me greke. Erdhi dikur avioni. Hipëm.

U takuam me parinë. Kemi shëtitur në të gjitha qytetet e nëpër krejt kalatë e Shqipërisë. Edhe në Butrint ishim. Në Tiranë varrezat e dëshmorëve i kishin rregulluar fort bukur, si lulishte. Shkuam ta vizitonim shtëpinë e Enverit. Hala gjallë ish Enveri. Mua më thanë është i sëmurë e ka shkuar në një shtet tjetër. Kadri Hazbiu e Mehmet Shehu kishin qenë prishur ndërmjet vete. Kemi shkuar dhe e kemi parë edhe shtëpinë e lindjes të Enver Hoxhës, e kishin bërë muze! E kam përkundur kështu djepin e Enverit. Kam ndenjur 18-19 ditë. Ngadalë, më tha Kadri Hazbiu. Rrimë edhe ndonjë ditë. Jo, i thashë, se duhet të shkoj në Amerikë.

Nuk vonoi tri-katër ditë, krisi bomba në Tiranë. Kisha dalë e



po ecja. Au, ku je, Terpezë, bre! Lum Kosova që të ka, bre!

Qysh u bë të kriste bomba, mbasi kishte dy-tri ditë që ju ishit kthyer në Amerikë?

– Nuk di unë. Unë bombën s'e kam qitur. Po unë kam qenë e kam këqyrur ambasadën. Kish qenë kollaj të qitet, se ishte si shpat. Tirana ka shpate. E kam këqyrur si ka qenë vërtet kollaj të qitet. Kam bërë diçka për Amerikë.

Mua katër vjet nuk më linte të hyja në zyrë Mustafë Xhemaili. Ky është tradhtar për Shqipëri, ka thanë. Tash miku më i madh. Ka shkruar libër. Ka bërë fotografi timen me të veten. Ka dalë në fotografi edhe me vajzën time kur ma kanë festuar ditëlindjen.

Kemi pas tubuar pare e ia kemi dhënë Bujarit. Hajde se kemi qeveri e po luftojmë?

– Kam dëgjuar. Unë e kam pas kuptuar se amerikanët kanë thënë pa luftuar Kosova, ne nuk mund të bëjmë gjë. NATO-ja nuk është veç për ne shqiptarët, por për gjithë botën.

Rugova ka rrëshqitur shumë. Ka shkuar Hollburku e i ka thënë

çohu. Merru vesh me UÇK-në. Jo, unë jam njeri i paqes e jo i terrorit. Ata po mbrojnë pragun e derës, familjen e vet. Jo, unë jo, po thotë ky. Unë, thotë, jam kryetar. Ai Thaçi s'ka pritur tri minuta e ka thanë, unë jam kryetar. Po këta nuk janë asnjëri. Kryetar është ai amerikan. Këtu është duke u kaurdisur punë e madhe, o djem. Unë nuk di sa ju, po jam gati, se i di do gjëra. Unë i kam mbërritur do gjëra t'i di e ju nuk i dini. Amerika mendon ndryshe, por nuk i qet. E ne mendojmë ndryshe. Mirë u bë kjo tash. Por, shumica e shteteve të Evropës kanë qejf që Kosova të mbetet nën Jugosllavi. Amerika nuk do ashtu. Franca ka qenë besnike e Ruisë dhe ashtu është prapë. Këto gjëra janë të thella, pasha mixhën. Sa më shpejt duhet t'i jepet zor e të ngjallet populli shqiptar. Të formohet qeveri. Të mos lihet në batak puna. Armiku nuk rri. Ai punon. Kur kam folur në Gjilan e në Ferizaj, u kam thënë se Sllobodani po thotë se hala nuk e kam humbur luftën. Rugova është gjallë. Çka i kam thënë në Tiranë, i ka dalë ashtu. Ka qenë aty edhe Sali Berisha, edhe

Bukoshi e do të tjerë. Me thanë, fol Tërpezë. Çka të flas? Ju po përpigjeni për paqe.

Serbia nuk e lëshon me paqe. Unë jam zero para jush, të gjithëve, por e di kush janë serbët. Ai serbi nuk e lëshon pa gjak. Luftën e Kosovës nuk e ka fituar Serbia, po Turqia. E ka bërë fitore Serbia me propagandë. Ka ndërtuar monumente. Tash po bën monument të car L Lazarit edhe në Gjilan. Po ndërton monumente edhe arave e livadheve. I kam parë.

Erdhi Sahit Kryeziu, gjakovari, intelektual i fortë është ai, na vizitoi. Ta bëjmë një Komitet. Mirë. Mua si kosovar më thërrisnin. Mbete. Kur dëgjova u formua komiteti. Erdhi një polic i Italisë me një letër në dorë. I lyp tre veta të Shqipërisë, unë i katërti. Thotë ju kanë thirrur në Romë. Hipëm në tren. Kur shkuam në Romë, na ka dalë përpara një shqiptar, na ka çuar në hotel. Ne na paskan thirrur për ta njohur komitetin. *(Intervistë e realizuar nga Sami Dërmaku, botuar në librin "Dëshmi kohe" nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Vijnon nesër) /Epoka e re/*

Iluzioni më i madh ku bien njerëzit, në epokën e mediave sociale



Është e kuptueshme pse shumica e njerëzve besojnë se mendimi i tyre ka rëndësi dhe shprehja e tij është e rëndësishme. Kjo është ajo që bëjnë të gjithë. Kjo temë është kudo në lajme dhe në internet, kështu që edhe ju duhet të kontribuoni dhe të thoni diçka, apo jo? Nuk është gjë tjetër veçse një iluzion.

Anna Lemind*

Nuk ka asnjë dyshim, se mediat sociale luajnë një rol vendimtar në jetën tonë sot. Jemi mësuar aq shumë të kontrollojmë newsfeed-in në Facebook dhe përditësimet e miqve tanë në Instagram sa nuk mund ta imagjinojmë veten pa këto gjëra.

Megjithatë, nevoja për të qëndruar vazhdimisht të lidhur dhe për të ndarë lajmet tona me botën nuk është thjesht një pjesë e jetës sonë. Ka ndryshuar gjithashtu mënyrën se si mendojmë, duke na bërë të bëhemi viktimë e iluzioneve dhe shtrembërimeve të ndryshme konjitive.

Do të doja të përqendrohesha në një prej tyre – nevojën iluzore për të pasur një mendim për gjithçka. Ta ilustroj konkretisht, më lejoni t'ju bëj disa pyetje:

Cili është mendimi juaj për paradoksin e Fermi?

Pse gjermanët nuk i shkatërruan trupat britanike në Dunkirk gjatë Luftës së Dytë Botërore?

Pse dështoi komunizmi?

Nëse nuk jeni eruditë të jashtëzakonshëm, me shumë mundësi do të përgjigjeni "Nuk e di" për disa ose të gjitha këto pyetje.

E shihni? Nuk ju vjen turp të pranoni se nuk dini diçka. Dhe nuk është aspak turp – nuk mund të dimë gjithçka. Në fund të fundit, jemi këtu për të mësuar dhe për të evoluuar.

Mjerisht, ne shpesh e neglizhojmë këtë të vërtetë të thjeshtë dhe biem në iluzionin se duhet të kemi një mendim kur bëhet fjalë për temat që janë tendencë e momentit.

Tani, më lejoni t'ju bëj disa pyetje të tjera:

Cilat ishin arsytet e fillimit të luftës në Ukrainë?

Cili është mendimi juaj për vaksinat kundër COVID-19?

Pse po rriten çmimet e energjisë?

Këtu, me shumë mundësi do të keni një përgjigje për të dhënë për secilën nga këto pyetje.

Por tani pyesni veten, sa dini në të vërtetë mbi këto tema? Nëse nuk keni një njohuri të gjerë të politikës, ekonomisë ose imunologjisë, ndoshta i dini këto gjëra në një nivel shumë sipërfaqësor.

Megjithatë, ju jeni të sigurt për mendimin tuaj.

Pra, pse përgjigjet tuaja ishin kaq të ndryshme? Ju thatë "nuk e di" në grupin e parë të pyetjeve, dhe megjithatë, grupit të dyta të pyetjeve iu përgjigjet me një shkallë të lartë sigurie.

Cili është ndryshimi?

Iluzioni i të paturit një mendim për gjithçka

Këtu arrijmë te thelbi i iluzionit për të cilin po flas. Një lidhje e vazhdueshme me mediat sociale dhe internetin na mashtron duke na bërë të besojmë se duhet të kemi një mendim për gjithçka. Për më tepër, mendimet tona kanë rëndësi.

Ju shkruani një postim dhe miqtë tuaj në Facebook reagojnë ndaj tij. Ju ngarkoni një selfie me një mesazh politik në Instagramin tuaj dhe njerëzit komentojnë. Ndjeheni sikur ajo që thoni është e rëndësishme.

Në realitet, nuk është e vërtetë.

Mendimi juaj ka rëndësi për sa

kohë që flisni për jetën tuaj dhe gjërat që dini. Nëse thjesht ndiqni reklamat, por keni një njohuri sipërfaqësore të temës, mendimi juaj nuk ka rëndësi sepse nuk sjell asnjë vlerë. Nëse nuk e keni studiuar dhe analizuar problemin në thellësi, thjesht përsërisni atë që keni dëgjuar nga të tjerët, keni lexuar në internet ose keni parë në TV.

Megjithatë, është e kuptueshme pse shumica e njerëzve besojnë se mendimi i tyre ka rëndësi dhe shprehja e tij është e rëndësishme. Kjo është ajo që bëjnë të gjithë. Kjo temë është kudo në lajme dhe në internet, kështu që edhe ju duhet të kontribuoni dhe të thoni diçka, apo jo?

Nuk është gjë tjetër veçse një iluzion.

Mund të jetë e vështirë ta pranosh këtë të vërtetë, sepse në epokën tonë të lidhjeve të vazhdueshme, është e çuditshme të qëndrosh larg zhurmës dhe të mos thuash asgjë. Mediat sociale janë këtu që të shprehemi, apo jo?

Në realitet, nuk keni nevojë të keni një mendim për gjithçka. Është në rregull të qëndroni larg temave të momentit dhe të mos keni fare mendim. Është në rregull të mos thuash asgjë.

Ju nuk keni nevojë të mbani anë dhe të krijoni këndvështrime për

temat për të cilat nuk dini asgjë, veçanërisht nëse ato qëndrojnë jashtë zonës tuaj të interesit. Nuk është turp të thuash "nuk e di" ose "nuk jam i sigurt" kur dikush të pyet për një çështje politike apo sociale.

Në fund të fundit, heshtja është e artë. Ndonjëherë është me të vërtetë më mirë të qëndrosh i heshtur.

Pra, herën tjetër që do të filloni një debat për një temë "të nxehtë" ose do të ndani një postim politik në Facebook, pyesni veten, Sa mirë e njoh temën?

A e kam studiuar problemin nga anë të ndryshme?

Mendimi im është në të vërtetë i imi apo thjesht po përsëris diçka që kam dëgjuar nga të tjerët ose në TV?

Ndoshta këto pyetje do t'ju ndihmojnë të shihni të vërtetën. Nevoja për të pasur një mendim për gjithçka është një iluzion.

Në të njëjtën kohë, nëse jeni vërtetë të interesuar për një problem në trend dhe dëshironi ta kuptoni më mirë, atëherë sigurohuni që ta studioni atë nga të gjitha këndvështrimet.

Lexoni, shikoni, mësoni. Më pas analizoni informacionin që keni konsumuar. Vetëm atëherë mund të thoni se keni dalë me përfundimet tuaja – jo të dikujt tjetër.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT Enveri PILKINGTON
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ancelotti: Nuk mund të them se Messi është më i miri në histori

MADRID, 29 DHJETOR - Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka komentuar në lidhje me Leo Messin, i cili para disa ditësh ka arritur ta fitojë trofeun e shumëkërkuar atë të Kupës së Botës. Pasi argentinasi e ka fituar

çmim të vetëm që i mungonte, për shumëkënd ka marrë fund dilema e lojtarit më të mirë në histori. Por, ashtu nuk mendon trajneri i "Mbretërve", Ancelotti. Sipas tij, në këtë epokë ka pasur shumë lojtarë të rëndësishëm.

"Është e vështirë të thuhet. Ai është një futbollist i madh. Karriera e tij është spektakolare, por nëse ai është më i miri në histori, nuk e di sepse çdo epokë ka pasur lojtarë shumë të rëndësishëm. Të thuash se ai ka qenë më i

miri në histori nuk do të dal nga goja ime. Unë i kam shijuar të gjithë lojtarët dhe tani kam një Top të Artë çdo ditë këtu (Benzema). Kam parë Maradona dhe Cruyff dhe i kam shijuar", ka thënë Ancelotti.



Jo vetëm Ronaldon, Al Nassri synon ta transferojë edhe Ramosin

RIAD, 29 DHJETOR - Jo vetëm Cristiano Ronaldon, Al Nassri ëndërron ta ndërtojë një ekip të madh. Sipas mediumit spanjoll "Marca", përpos yllit portugez, klubi nga Arabia Saudite është duke e përgatitur një ofertë të majme edhe për ish-shokun e skuadrës së portugezitet në kohën e Real Madridit, Sergio Ramosin. Veterani i mbrojtjes po e kalon sezonin e fundit të kontratës me PSG-në dhe në qershor do të jetë lojtar i lirë. Deri tash nuk ka zhvillime konkrete sa i përket një vazhdimi eventual të kontratës. Edhe pse drejtuesit e Al Nassrit e dinë se ish-përfaqësuesi spanjoll

dëshiron të luajë ende në nivele të larta të futbollit evropian, ata do të provojnë ta bindin atë që t'u bashkohet përmes një oferte marramendëse. Mbetet të shihet nëse Ramos do të vendosë t'i bashkohet Ronaldos në Lindjen e Mesme. "CR7" është thënë se do të paguhet deri në 200 milionë dollarë në vit në Al Nassr, të cilit pritet t'i bashkohet në ditët në vazhdim. Ndërkohë, Ramosi, nëse nuk e merr një ofertë nga PSG-ja për vazhdimin e kontratës dhe nëse nuk e duan klubet e mëdha evropiane, mund të vendosë të shkojë në klubin e pasur arab.



Gakpo: Van Dijku më bindi t'i bashkohem Liverpoolit

LIVERPOOL, 29 DHJETOR - Ylli i Holandës, Cody Gakpo, është transferuar në Liverpool. Gakpo ka bërë me dije se ka qenë bashkëvendësi i tij, Virgil van Dijk, që e ka bindur atë t'i bashkohet "The Reds". "Në ditët e fundit folëm shumë me të në telefon. Ai më tha se kjo është lëvizje e duhur për t'u zhvilluar dhe për t'u bërë një lojtar i madh. Ai më tha se Liverpooli është klub i madh. Gjithashtu jam i lumtur që ai është këtu, sepse ai mund të më ndihmojë në shumë gjera. Jam vërtet i lumtur që jam

këtu", ka thënë Gakpo. Ndërsa menaxheri i Liverpoolit, Jürgen Klopp, ka lavdëruar transferimin e ri të skuadrës së tij, Cody Gakpo. Klopp është i bindur se Gakpo do të ketë të ardhme të ndritshme në "Anfield". "Gakpo, lojtar i madh, por edhe një djalë i zgjuar. Kemi arritur të nënshkruajmë me një lojtar që e njohim prej shumë kohësh... dhe që besojmë se do të ketë një të ardhme vërtet të ndritur me ne. Më besoni, ai ka potencial të madh", ka thënë Kloppi.


Lewandowski: Në Barcelonë ndihem si në shtëpinë time

BARCELONË, 29 DHJETOR - Sulmuesi polak i Barcelonës, Robert Lewandowski, në një intervistë për mediet spanjolle, ka thënë se ndihet

jashtëzakonisht mirë te klubi katalonas. Reprerentuesi i Polonisë është duke luajtur sezonin e tij të parë te Barcelona pas transferimit nga Bayern

Munich. Ai ka thënë se në Barcelonë ndihet si në shtëpinë e tij. "Gjatë Kupës së Botës isha larg nga qyteti i Barcelonës dhe kur u ktheva m'u duk sikur po kthehesha

në shtëpi. Isha larg klubit dhe qytetit tim dhe kjo ndjenjë do të thotë shumë për mua. Jam shumë i lumtur këtu", ka thënë Lewandowski.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i punës/Pozita: Auditor i Lartë i Teknologjisë Informative
Departamenti/Divizioni: Departamenti i Auditimit të Brendshëm (Dab)
I raporton: Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm
Niveli i gradës: 4

Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës:

Auditori i Lartë i Teknologjisë Informative (TI) kryen auditime të teknologjisë informative, të pajtueshmërisë, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me standardet për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, si dhe bënë vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve. Auditori i Lartë i Teknologjisë Informative punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së.

Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e Brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raportet, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit dhe Teknologjisë Informative, sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e AB-së, Kodin e Etikës, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilën rregullohet fushëveprimtaria e auditimit të brendshëm.

Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante) duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm të teknologjisë informative, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve të teknologjisë informative në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transakcionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Drejtorit të DAB-it, apo vetë departamentit.

Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të punonjësve në Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Departamentit të Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

Përgatitjet profesionale/kualifikimet:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, shkencave kompjuterike, elektroteknike, shkencave matematiko-natyrore, apo relevante;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e Teknologjisë Informative (përvoja në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Çertifikatë profesionale në fushën e Teknologjisë Informative ose auditimit të brendshëm (çertifikata në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Njohuri mbi fushat e ndryshme të teknologjisë informative si: zhvillimi i softuerit, sistemet operative, menaxhimi i data bazës, dhe rrjeta;
- Njohuri mbi kornizën dhe standardet si COBIT, ISO 27001, ITIL, etj;
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente;
- Raporti nga Trusti i cili e dëshmon periudhën kohore të përvojës së punës;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

